



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

29 dhjetor 2021

C-IV-14-3556

Ankuesi

M Th Prizren.

Kundër

E paditura

Agjencia Kosovare e Privatizimit, rruga “Agim Ramadani”, nr. 23, Prishtinë.

Për: Palët

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Dhoma e Posaçme), gjyqtari Sylejman Shumolli, me 29 dhjetor 2021, lëshon këtë:

A K T V E N D I M

- 1. Procedura në këtë çështje juridike NDËRPRITET për shkak të vdekjes së ankuesit J Th, nga Prizren.**
- 2. Procedura do të vazhdohet kur trashëgimtarët e të ndjerit kërkojnë vazhdimin, apo kujdestari i tij kërkon vazhdimin e procedurës, apo kur gjykata në bazë të propozimit të palës së kundërt kërkon që palët të vazhdojnë procedurën.**

Rrethanat faktike dhe procedurale

Me 12 maj 2014, parashtruesi J Th, parashtroj ankesë kundër Vendimit të Autoritetit të Likuidimit (tutje AL-ja) PRZ002-0172 të datës 21 prill 2014, me të cilin i ishte refuzuar si e pa vlefshme kërkesa për kompensim për paga të papaguara, në shumë prej 1,500.00 €, nga NSH “Kosova Vera”, (në likuidim).

Me 19 shtator 2014, vërejtja për pagesën e taksës gjyqësore i është dorëzuar ankuesit.

Me 24 shtator 2014, në Dhomën e Posaçme ankuesi parashtroi kërkesë për lirim nga taksa gjyqësore, duke ia bashkangjitur deklaratën për mjete financiare.

Me 15 shtator 2021, Dhoma e Posaçme lëshoi urdhër për ankuesin, me të cilën kërkoi, që të paraqes vendimin e AKP-së dhe prova shtesë në mbështetje të pretendimeve të tij ankimore.

Me 24 shtator 2021, në urdhrin e lëshuar nga gjykata është përgjigjur djali i ankuesit M Th dhe ka bashkangjitur vendimin e AKP-së, certifikatën e vdekjes dhe librezën e punës e tashmë të ndjerit J Th.

Me 25 tetor 2021, e paditura ka parashtruar mbrojtje në ankesë, në të cilën pohoi se AL ka kryer një vlerësim të saktë të rrethanave faktike dhe se dispozitat ligjore janë zbatuar saktësisht.

Arsvetimi ligjor

Procedura në këtë çështje juridike ndërpritet për shkak të vdekjes së ankuesit.

Neni 76.3 i Ligjit Nr.06-L-086 Për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës parasheh:

Në interpretimin dhe zbatimin e këtij ligji, kudo që është e nevojshme për të zgjidhur një çështje procedurale që nuk trajtohet mjaftueshëm me këtë ligj, Dhoma e Posaçme do të zbatojë mutatis mutandis dispozita përkatëse të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore.

Sipas dispozitës së nenit 277 pika (a) të LPK-së:

Procesi gjyqësor ndërpritet:

a) kur pala ndërgjyqëse vdes ose e humbë zotësinë procedurale, e nuk ka të caktuar përfaqësues me prokurë në gjykim;

Në vazhdim dispozita e nenit 280 par. 1 të LPK-së parasheh:

Procedura që është ndërprerë për shkaqe të treguara në nenin 277 paragrafi 1 pika a)–d) të këtij ligji do të vazhdohet kur trashëgimtari, apo kujdestari i pasurisë trashëgimore, përfaqësuesi i ri ligjor, administratori i falimentimit apo pasardhësi juridik i personit juridik, e marrin përsipër procedurën apo kur i thërret gjykata ta bëjnë këtë, me propozimin e palës kundërshtare.

Me 24 shtator 2021, Gjykata ka pranuar nga familjari i ankuesit/djali i tij, M Th përgjigjen në urdhër të cilit ia ka bashkangjitur edhe certifikatën e vdekjes për ankuesin J Th. Me certifikatën e vdekjes e lëshuar nga Ministria e Punëve të Brendshme, Zyra e Gjendjes Civile në Prizren, me numër rendor 749 dhe numër të referencës 20/2015RV/2001 të datës 06 nëntor 2017, me anë të së cilës vërtetohet fakti se ankuesi, tani i ndjeri J Th, ka vdekur me datë 06 nëntor 2015 në Prizren.

Andaj, duke u nisur nga gjendja e tillë e çështjes, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi, konform nenit 277 pika (a) dhe nenit 280 par. 1 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK).

Këshillë juridike

Kundër këtij aktvendimi mund të parashtrohet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme brenda 15 ditëve nga pranimi i këtij aktvendimi. Ankesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 9.6 të Ligjit për Dhomën e Posaçme.

Sylejman Shumolli
Gjyqtar

Urdhër për zyrën e regjistrimit

Aktvendimi duhet t'i dorëzohet palëve.